

SHP PROBISHTIP

# NJË PUSHIM QË DO TË MBAHET MEND GJATË

Turni i parë i 54 pensionistëve u nisën më 19 korrik dhe u kthye më 27. Grupi i dytë prej 50 pensionistësh të Shoqatës u nisën më 5 gusht dhe u kthye më 13 gusht. Të dy grupet u vendosën në kompleksin hotelierik Koloveri Resort që ndodhet në pjesën jugore të Shqipërisë në qytetin e Kavajës pranë Durrësit

Përpara shfaqjes së pandemisë së Covid 19, pensionistët nga SHP Probishtip pushuan në "detin tonë" siç na pëlqen ta quajmë edhe sot Detin Adriatik. Shumë të kënaqur me përshypjet e shumta që kanë rrëfyer prej kohësh, me dëshirën për të shkuar të paktën edhe një herë në plazhet e Shqipërinë fqinje. Dëshira e shumë njerëzve u përbush këtë vit kur u liruan masat nga pandemia. Kështu, shoqata e pensionistëve vendosi të organizojë këtë vit pushime verore në Shqipëri. Kjo u realizua në bashkëpunim me Agjencinë turistike HAK-BUS nga Tetova. Pushimi ishte me dy turne në Kavajë.

Turni i parë i 54 pensionistëve u nisën më 19 korrik dhe u kthye më 27. Grupi i dytë prej 50 pensionistësh të Shoqatës u nisën më 5 gusht dhe u kthye më 13 gusht. Të dy grupet u vendosën në kompleksin hotelierik Koloveri Resort që ndodhet në pjesën jugore të Shqipërisë në qytetin e Kavajës pranë Durrësit. Çmimi i pushimeve verore ishte shumë i përballueshëm. Për vetëm 9,900 denarë ata kishin 7 pansione të plota, plus një ditë që e përdornin për banjë dielli, e cila do të thuhet se



ishite 8 ditë e shijimit të plazheve të bukura në Detin Adriatik, duke përdorur ditët e nxehta të verës. Udhëtimi ishte me autobusë shumë të rehatshëm, me ajër të kondicionuar, dhe për akomodimin në hotele kishin vetëm fjalë të bukura Dobrica, Makedonka, Rajna dhe disa të tjerë, të cilët patën mundësinë të shkojnë me pushime këtë vit. Dhomat ishin të rregulluara me të gjitha standardet me ajër të kondicionuar, me banjo të veçanta dhe në çdo dhomë një frigorifer. Dhe jo vetëm dhomat e hotelit, por edhe çadrat dhe shezlongët në plazhe, dhe uji i pastër dhe higjiena në bregdet ishte për t'u dëshiruar. "Përveç grupit tonë, e kam fjalën për grupin e dytë, në vendpushim kishte pensionistë nga Velesi, Koçani, Strumica, Shkupi dhe mysafirë nga Polonia. Qëndrimi ynë nuk përbëhej vetëm nga rrezet e diellit dhe shijimi i plazhit, përkundrazi, takimet e mbrëmjes ishin një histori e veçantë. Në grupin tonë, si dhe nga shoqatat e tjera, kishte pensionistë që morën me

vete instrumentet e tyre të preferuar, kështu që, në mbrëmje këndoheshin këngë maqedonase dhe luhej valle. Këto ishin mbrëmje të paharrueshme, muzika e të cilëve u përhap në të gjithë Kavajën, dhe jo vetëm në maqedonasit kërcyen, por edhe mysafirët nga Polonia, si dhe popullata, të cilët me kënaqësi erdhën të shoqëroheshin me ne. Kështu, lindën miqësi të reja, u shkëmbyen njohje të reja, u shkëmbyen numrat e telefonit, me dëshirën që një shoqërim i tillë të vazhdojë, përmes bisedave", tha Dobrica, dukshëm e emocionuar dhe me humor të mirë. Rajna Jankoviq gjithashtu nuk e fshehu kënaqësinë që gjeti te kolegët e saj pensionistë për të kaluar pushimet verore së bashku në Shqipëri, por ajo nuk harroi të shprehë mirënjohje të madhe për menaxhmentin e SHP Probishtip që u mundësoi atyre të bëjnë pagesën në dy këste, e cila veçanërisht ishte e favorshme për pensionistët me të ardhura më të ulëta. M. Zdravkovska

PENSIONISTËT NË KUMANOVË



## Projekti me moton "Buzëqeshje për më të moshuarit"

Në shtëpinë për të moshuar "Zafir Sajto" – Kumanovë realizohet projekti "Buzëqeshje për më të moshuarit", si pjesë e aktiviteteve të këtij lloji që ka filluar t'i realizojë Komuna e Kumanovës me një qëllim të vetëm që të zbkurohet mjedisi i përditshëm i personave të moshuar, të cilët qëndrojnë në Shtëpinë e pleqve.

Tre artistë nga Kumanova – grafistë në Shtëpinë e të moshuarve vizatojnë grafitë në sipërfaqe prej 100 m2. Jepet respekti dhe mbështetja për artistët e rinj, si dhe një falënderim i ngrohtë në emër të shfrytëzuesve të Shtëpisë së të moshuarve. Këta të rinj punuan shumë që në mënyrë të vërtetë të pikturojnë pleqërinë me ngjyrën e saj të vërtetë. Kur dëshironi të pikturoni pleqërinë në pikturë me një përzgjedhje ngjyrash, do të mendoni se si do të pikturoni një jetë, me një forcë të rënduar mbi supe, drithëruese të bartur nga erërat, hapa të ngadalësuar dhe të ndihmuar nga një bastun.

Që në oborrin e Shtëpisë kur të futeni, mirëseardhje do t'ju dëshirojë piktura e parë e cila është e vizatuar nga rinia jonë, të cilës duhet t'i besojmë, ta mbështesim dhe aq më shumë ta motivojmë, sepse vlerat e jetës janë në ndryshimin e vazhdueshëm dhe në miqësinë mes gjeneratave. Qëndroni para pikturës dhe shihni pleqërinë në sy. Brenda ngjyrave lozonjare fshihet e vërteta se edhe pleqëria ka bukurinë e saj dhe ngjyrat e hareshme, dhe prandaj është privilegj dhe dëshirë që çdokush të pres pleqërinë. Piktura duket se ju flet

dhe ju thotë se këtu nën këtë kulm nuk është ndalur koha, se jeta vazhdon përmes shoqërimit aktiv në tri ngjyrat themelore: të kuqes, të gjelbrës dhe të verdhës.

Disa hapa më tutje do t'ju pret një pikturë e dytë dhe ndoshta do të mendoni se jeta në pleqëri duket sikur një pellg, por menjëherë do të befasoneni nga bukuria e ndriçimit të verdhë mbi kallamishtet. Pikërisht ai ndriçim i ngjyrës premtion shpresë dhe besim në shumë lindje të tjera të diellit.

Ne nuk duhet t'i harrojmë rrënjët tona, traditën tonë nga e cila të rinjtë do ta marrin të dobishmen dhe do të vazhdojnë rrugën duke e respektuar dhe ruajtur atë. Dhe atë do ta shihni në pikturën e tretë, e cila tregon për atë se kush jemi, cilët janë rrënjët tona pa të cilat nuk ka jetë as shtyllë, dhe as fidanë të rinj.

Pikturat janë një pasqyrim i mendimeve dhe ato nuk janë vetëm nga duart e artistëve të rinj, por janë edhe një zgjim, mendim dhe respektim i pleqërisë që na pret të gjithëve. Për pleqërinë kur flitet nuk është lehtë të gjenden fjalët më të mira, më të vërteta. Kur në kokë të mblidhen kujtimet si një tufë bletësh, është e kotë të përpiqeni që ato t'i radhitni me radhë. Ndërsa i shikoni ashtu të ulur në oborr me sytë e tyre të vegjël të përshtatur në kornizën e pabarabartë të rrudhave, me mendime prapa në të kaluarën, ku kujtimet e palosura mbulohe me brez të kohës që udhëton drejtë harresës. Rosica Mitiq

PËRVJETORI I LSHPM

## Shtatëdhjetepesë vjetori i organizimit të pensionistëve në Maqedoni

Shtatëdhjetepesë vjetorin e organizimit të pensionistëve në Maqedoni, Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, këtë vit do ta shënojë denjësisht dhe me shumë manifestime dhe ngjarje të rastit. Ky jubile i madh i rrallë i një prej organizatave më të vjetra joqeveritare në vend do të shënohet në mënyrë sikurse dinë ta bëjnë pensionistët, me shoqërimë, me këngë e valle, me gara sportive, lexime poetike, me botim të Monografive për të arriturat dhe ndërtimin e bashkëjetesës, për aktivitetet humanitare dhe të tjera. Si zakonisht, jubiletë

janë ngjarje rasti për të përmblodhur rezultatet dhe të arriturat gjatë viteve të kaluara, për të bërë analizën e të njëjtave dhe të përcaktohet udhërrëfytyrës dhe orientimi i më tutjeshëm i rrugës drejtë së cilës do të shkohet në të ardhmen.

Edhe në LSHPM është ashtu. Festimi dhe shënimi filloi me heqjen e kufizimeve nga pandemia e Koronavirusit në vend dhe në botë. Në të gjitha seancat dhe takimet krahas zhvillimeve aktuale u prezantuan edhe të arriturat e Lidhjes gjatë viteve të kaluara.

Ashtu ishte në tetë revytë rajonale të këngëve, muzikës dhe valleve, ashtu ishte edhe në Revynë e 11-të me radhë Republikane të këngëve, muzikës dhe valleve në fjalimin e kryetares së LSHPM, Stanka Trajkova, si dhe në fjalimin Kryeministrit të Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev i cili ishte mbështetës dhe mysafir nderi, i cili e shpalli revynë si të hapur.

E njëjta gjë do të jetë edhe në jubileun e 25-të me radhë, Olimpiadës së tetë rajonale dhe republikane të pensionistëve që do të mbahet këtë vit në Veles dhe në dy në dy Recitimet poetike në Nebre-

govë dhe Radovish ku do të marrin pjesë poetë pensionistë. Si çdoherë fundin do ta zbkurojë vepra. Më 20 shtator Ditën e pensionistëve të vendit tonë, do të mbahet Seanca solemne e Kuvendit të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë në të cilën do të marrin pjesë mysafirë të lartë të vendit dhe të huaj, si dhe përfaqësues të institucioneve dhe organizatave me të cilat LSHPM ka bashkëpunim të frytshëm, përfaqësues të mediave, ndërsa do të ketë dekorime me mirënjohje dhe falënderime.

Kalina S. Andonova

